



BASHKIA MIRDITË

BULETINI I MUAJIT TETOR 2025

Mundësi të reja bashkëpunimi për fermerët dhe bizneset lokale në Mirditë.

Më datë 11 tetor 2025, Bashkia Mirditë organizoi një takim me fermerët dhe përfaqësuesit e bizneseve lokale, në bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Dhomën e Tregtisë, Industrisë dhe Agrikulturës së Kozencës (Itali) dhe kompaninë “Madeo Group”.

Takimi u fokusua në zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë, duke prezantuar praktikrat e suksesshme të ar-bëreshëve në Itali, që mund të shërbejnë si modele për fermerët mirditorë.

Kryetari i Bashkisë Mirditë, z. Albert Melyshi, u shpreh se: “Bujqësia dhe blegtoria kanë qenë gjithmonë ndër shtyllat kryesore të jetesës për familjet mirditore. Sot, pjesa më e madhe e tokës bujqësore në Mirditë është e papunuar. Vetëm nëse arrijmë të prodhojmë, do të kemi zhvillim të vërtetë ekonomik.”

Kryetari i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, z. Nikolin Jaka, theksoi se potenciali natyror i Mirditës është i jashtëzakonshëm dhe duhet të shndërrohet në prodhim, vlerë dhe punësim.

Pjesëmarrja e Konsulles së Nderit të Shqipërisë në Itali, znj. Anna Madeo, njëkohësisht përfaqësuese e kompanisë “Madeo Group”, një emër i njohur ndërkombëtarisht për prodhimin e mishit, sallamrave, proshutave dhe produkteve tradicionale italiane, i dha rëndësi të veçantë këtij takimi.

Znj. Madeo prezantoi për fermerët e Mirditës mundësi konkrete bashkëpunimi që mund të zhvillojnë prodhimin lokal dhe të hapin tregje të reja si:

- prodhimi i i vajit të ullirit.
- rritja e derrave dhe përpunimi i mishit.
- prodhimi i djathit të bardhë.
- prodhimi i specave dhe produkteve të tjera tradicionale.

Të gjithë fermerët e interesuar, për më shumë informacion dhe për t’u përfshirë në këtë iniciativë, janë të lutur të paraqiten pranë Bashkisë Mirditë.



Tetori Rozë - Muaji i ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit.

Tetori është muaji që na fton të ndalojmë për një moment dhe të kujtojmë një të vërtetë të rëndësishme: kontrolli dhe diagnostikimi i hershëm shpëtojnë jetë.

Gratë dhe vajzat janë themeli i shoqërisë sonë.

Në këtë muaj ndërgjegjësimi, të gjithë ne mund të bëjmë një hap të vogël me një ndikim të madh:
të nxisim kontrollin periodik, të informojmë dhe të mbështesim të gjitha ato që po përballen me këtë sfidë.

Kontrolli shpëton jetë, bëje për vete, bëje për ata që të duan. Bëje për shoqërinë tonë.

Aktiviteti u organizua nga Bashkia Mirditë, në bashkëpunim me Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Mirditë, Aleancën e Këshilltareve Bashkiake Mirditë, ZVAP Mirditë, Vizion Ojf, Mary Ward Loreto dhe Opportunity, Balance & Overcoming.



ReLOaD3

Në kuadër të Programit ReLOaD3, në datat 8-9-10 Tetor, pranë Qendrës Rinore “Atelie” në Shkodër u zhvillua trajnimi për stafin e bashkive partnere Mirditë, Lezhë dhe Shkodër.

Gjatë këtyre ditëve, pjesëmarrësit u angazhuan në një program të strukturuar për të trajtuar temat kryesore të shkrimit dhe menaxhimit të projekteve, duke i parë ato nga dy këndvështrime:

Si aplikues në programe të rëndësishme të Bashkimit Europian.

Dhe nga pikëpamja e donatorit, përmes sesioneve që prezantojnë metodologjinë LOD, si në rastin e bashkive pjesëmarrëse në programin ReLOaD

ReLOaD3 synon të forcojë demokracinë vendore përmes bashkëpunimit të pushtetit vendor dhe organizatave të shoqërisë civile, duke rritur njëkohësisht pjesëmarrjen e qytetarëve në vendim-marrje.



Njoftime

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Bashkisë Mirditë, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë dhe trajtimin me prioritet të procedurave administrative të papërfunduara, për legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonat informale të banimit”, ju njoftojmë se:

Të gjithë Ju që keni ndërtime në proces legalizimi, në zonat e përcaktuara, mund të paraqiteni pranë Bashkisë Mirditë për të marrë informacion mbi ecurinë e aplikimeve dhe procedurat e mëtejshme.



Konsultimet publike

Mbështetur në Ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore, në Ligjin nr. 9936 date 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, në ligjin nr.68/2017 Për financat e Vetëqeverisjes Vendore, Udhëzimin Nr. 9 datë 20.07.2018 Për Procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit, si dhe në Urdhërin Nr. 500 dt. 23.10.2025 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë “Për Ngritjen e Komisionit Për Konsultimet Publike” në kuadër të hartimit të Buxhetit Vjetor dhe Paketës Fiskale për vitin 2026, si dhe miratimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, të Bashkisë Mirditë.

Bashkia Mirditë fton të gjithë qytetarët, përfaqësuesit e biznesit, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit të marrin pjesë në konsultimet publike, duke dhënë mendimet, propozimet dhe sugjerimet e tyre mbi prioritetet e zhvillimit dhe planifikimin e buxhetit vendor.

GRAFIKU I KONSULTIMEVE

Njësia Administrative	Data	Ora	Vendi i takimit	
KAÇINAR	10.11.2025	10:00	Nj. Administrative Kaçinar	Takim me banorët e Nj.A Kaçinar dhe kryetarët e fshatrave.
SELITË	11.11.2025	09:30	Nj. Administrative Selitë	Takim me banorët e Nj.A. Selitë dhe kryetarët e fshatrave.
KTHELLË	11.11.2025	12:30	Nj. Administrative Kthellë	Takim me banorët e Nj.A Kthellë dhe kryetarët e fshatrave
FAN	12.11.2025	09:00	Nj. Administrative Fan	Takim me banorët e Nj.A Fan, dhe kryetarët e fshatrave
OROSH	12.11.2025	12:00	Nj. Administrative Orosh	Takim me banorët e Nj.A Orosh dhe kryetarët e fshatrave
RUBIK	13.11.2025	10:00	Nj. Administrative Rubik	Takim me banorët e Nj.A Rubik dhe kryetarët e fshatrave
RRËSHEN	14.11.2025	10:00	Pallati i Kulturës	Takim me banorët e Nj.A Rrëshen dhe kryetarët e fshatrave
RRËSHEN	14.11.2025	13 ⁰⁰	Salla e Këshillit Bashkiak, Bashkia Mirditë	Takim me Përfaqësues të Biznesit Mirditë

KRYETARI
Albert MËLYSHI



ADRESA: SHESH "MIAT DOCT" MIRDITË

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

Festo n'Mirditë.

Në datat 17 - 18 tetor 2025, në kuadër të projektit “Mirdita–Junik”, u zhvilluan aktivitetet festive “Festo n'Mirditë”, të cilat sollën gjallëri, kulturë dhe traditë në disa zona të Mirditës.

Aktivitetet nisën me hapjen e panairit të artizanëve në sheshin “Abat Doçi” në Rrëshen, kuartizanë vendas ekspozuan produkte tradicionale e punime artistike.

Në orët e pasdites, vizitorët u drejtuan drejt fshatit Domgjon, ku vizituan Gurrën e Domgjonit, Monument Kulture i Kategorisë së I-rë, një ujësjellës unik që dëshmon mjeshtërinë tradicionale të përpunimit të gurit nga brezat e kaluar.

Mbrëmja u mbyll me një koncert festiv, që solli atmosferë gëzimi dhe bashkimi për banorët dhe vizitorët.

Dita e dytë vijoi me vizitë në panairin e artizanëve, ndjekur nga një aktivitet në ish- Burgun e Spaçit, organizuar nga Shoqata “Tek Bunkeri”, ku të pranishmit patën mundësinë të njihen me një tjetër dimension të së kaluarës sonë dhe rëndësinë e ruajtjes së kujtesës historike.”

Pasdite, pjesëmarrësit vizituan Kishën e Rubikut, një nga monumentet më të rëndësishme të trashëgimisë shpirtërore në Mirditë, ndërsa aktivitetet u mbyllën me një koncert recital nga artistët e Musica Nova Ensemble pranë Infokullës Rubik.

Aktivitetet u mbështetën nga Bashkimi Evropian, përmes programit IPA CBC Shqipëri–Kosovë, dhe u zbatuan nga CHwB Kosovë, Bashkia Mirditë, Komuna Junik dhe Qendra UET.

Projekti synon të krijojë një infrastrukturë turistike të qëndrueshme në zonën kufitare mes Shqipërisë dhe Kosovës, duke promovuar atraksionet kulturore dhe natyrore, dhe duke sjellë përfitime ekonomike dhe sociale për komunitetet lokale.

Panairi i artizanëve në sheshin “Abat Doçi”.



Koncert në fshtatin Domgjon.



Vizitë pranë Kishës së T'Shëlbuemit Rubikut.



KONCERT NGA ARTISTËT E MUSICA NOVA ENSEMBLE
PRANË INFOKULLËS RUBIK.



AKTIVITET NË ISH-BURGUN E SPAÇIT, ORGANIZUAR NGA SHOQATA “TEK BUNKERI”.



Mbledhja e Këshillit Bashkiak Mirditë.

Me datë 31 Tetor 2025 u zhvillua mbledhja e radhës së Këshillit Bashkiak Mirditë ku u miratuan projekt –vendimet e mëposhtme:

P/Vendim nr. 4145/1 prot; “Për miratimin e përfitimit të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar, për bllok-ndihmën deri në 6%, për periudhën 01 - 30 Shtator 2025”.

P/Vendim nr. 4249/1 prot; “Për miratimin e përfitimit të ndihmës ekonomike, për bllok-ndihmën me fondine bashkisë, për periudhën 01 – 30 Shtator 2025”.

P/Vendim nr. 4296/1 prot; “Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet; Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Mirditë si dhe miratimin e metodologjisë LOD për financimin e organizatave të Shoqërisë Civile”.

P/Vendim nr. 4336/1 prot; “Për një shtesë në buxhetin e vitit 2025, sipas Aktit Normativ nr. 10, datë 08.10.2025, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2024, për buxhetin e vitit 2025 të ndryshuar”, Bashkia Mirditë.

P/Vendim nr. 4408/1 prot; “Për përdorim fond i mbrojtje civile, për ndërtim Urë Auto”, njësia administrative Fan, Bashkia Mirditë (shqyrtuar në mbledhjen e datës 29. 10. 2025, të Komisionit të Ekonomisë).

P/Vendim nr. 4199/1 prot; “Për lënien në fuqi të tarifave ekzistuese të ujit të pijshëm, grumbullimit e largimit të ujërave të ndotura”, Bashkia Mirditë.

